

Mundësi punësimi:

Koordinatorë projekti pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

Tiranë, më 21.07.2019

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare njofton të gjithë personat e interesuar se shpall pozicionin vakant për kordinatorë projekti¹.

Kandidatët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Të kenë përfunduar studimet në nivelin Bachelor në degë si shkenca politike, shkenca shoqërore ose degë të ngjashme me to;
- Të njohin programet bazë të kompjuterit;
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze;

Preferohen:

- Të kenë aftësi pune në grup;
- Të kenë pasur eksperiencë si anëtarë/e të skuadrave pro-bono ose angazhime të tjera pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare;

Në përputhje me Nenin 142/2 të Kodit të Punës, të ndryshuar, muaji i parë i punës do të konsiderohet si kohë prove.

Me qëllim aplikimin në këtë pozicion, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

1. CV e kandidatit/es;
2. Kopje të Diplomës, të shoqëruar me kopje të listës së notave të studimeve në nivelin Bachelor;
3. Çdo dokumentacion të nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es;

Afati i fundit i aplikimeve do të jetë data 31 Korrik 2019, ora 16.00.

Dokumentacioni mund të dërgohet i skanuar në adresën e emailit avokatore2@yahoo.com ose, të depozitohet pranë zyrave të Qendrës për Nisma Ligjore me adresë Rruga “Vaso Pasha” Pll.12, Shk.1, Ap. 1 Tiranë.

¹Aplikanti i suksesshëm do të koordinojë projektin: "Komunitetet të parat: krijimi i një Rrjeti të organizatave të shoqërisë civile për të adresuar ekstremizmin e dhunshëm - nga parandalimi në ri-integrim". Projekti zbatohet nga QNL në bashkëpunim me Forum MNE (Mal i Zi), Partners Kosova – Center for Conflict Management (Kosovë), Centre for Common Ground (Maqedoni), DamaD Kulturri Centar, Novi Pazar (Serbi) dhe Hope and Homes for Children (Bosnje & Herzegovinë), me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.